



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:026712

Datë: 02.04.2019

Numri i dokumentit: 00293149

P.nr.953/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija pranë kësaj Gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. Inga Peja, për shkak të veprës penale: të sulmit nga neni 187 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.nr.1492/2017, të datës 18.12.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik, **me datë 21.03.2019**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datën 02.04.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R. I., nga i ati J. e ëma V., e gjinisë O., data e lindjes . . . në Pejë, ku edhe tani jeton në rrugën “. . .”, , i martuar, baba i 2 (dy) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i Agresionit “. . .” në Pejë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 18.08.2017, në rrugën “. . .” në Gjakovë pa pëlqimin e personit tjetër përdor forcën ashtu që ditën kritike pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarin A. Gj.nga Gjakova, në një rënë anë dhe të akuzuarit në anën tjetër lidhur me mospajtimin e tyre rreth shitjes së disa biletave të udhëtareve të kompanisë së tij, ditën kritike rreth orës 09:30 minuta, e godet me grusht në fytyrë të dëmtuarin A., me çka ndaj tij ka përdor me dashje forcë dhe sulm fizik ndaj trupit dhe shëndetit të tij.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 46, 73, 74 dhe nenit 187 par.1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej treqind (300) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi atëherë të akuzuarit

dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

I dëmtuari A. (H.) Gj.nga Gjakova, me banim në rrugën “. . .“ nr. . . , për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.1492/2017, të datës 18.12.2017, kundër të akuzuarit R. I nga Peja, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit R. I andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari R. I., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe ka shtuar se është penduar për këtë veprim dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla por thekson se me të dëmtuarin janë pajtuar nuk kane asgjë te keqe prandaj i kërkoj falje edhe publikisht të njëjtit.

Prokurori i shtetit, Bajram Kryeziu, deklaroi se: nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë po ashtu pranimin i fajësisë mbështetet edhe në provat dhe faktet që janë bashkangjitur aktakuzës andaj i propozoi Gjykatës që i njëjti të shpallet fajtorë për veprën penale dhe të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale, po ashtu nga gjendja faktike me aktakuzë formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari R. I., me datë 18.08.2017, në rrugën “. . .” në Gjakovë pa pëlqimin e personit tjetër përdor forcën ashtu që ditën kritike pas një mosmarrëveshje më të dëmtuarin A. Gj.nga Gjakova, në një rënë anë dhe të akuzuarit në anën tjetër lidhur me mospajtimin e tyre rreth shitjes së disa biletave të udhëtareve të kompanisë së tij, ditën kritike rreth orës 09:30 minuta, e godet me grusht në fytyrë të dëmtuarin A., me çka ndaj tij ka përdorur me dashje forcë dhe sulm fizik ndaj trupit dhe shëndetit të tij.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurorja e shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës përkatësisht pushimin e procedurës penale.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KPRK-së dhe për

këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se: është baba i dy fëmijëve, është mbajtës i familjes prej 6 (gjashtë) anëtarësh, në gjykim ka patuar qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.953/17, me datë 21.03.2019

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.